



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:902335
Datë: 17.08.2021
Numri i dokumentit: 02091912

Ac.nr.63/18

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Ademi - kryetar i kolegjit, Rustem Thaqi dhe Zenel Leku, anëtar të kolegjit, me zyrtaren ligjore Biondina Zeneli, në çështjen juridike -kontestimore të paditësit I.H. nga Komuna e Junikut kundër të paditurit A. (M.) K. nga Komuna e Junikut, baza juridike kompensim dëmi, vlera e kontestit 11.000.00 euro duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurve të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë –Dega në Deçan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.50/2014, i datës 18.04.2016, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 04.08.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e paditësit I.H. nga Komuna e Junikut, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë –Dega në Deçan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.50/2014, i datës 18.04.2016, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.50/2014, i datës 18.04.2016, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur që: REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit I.H. nga Komuna e Junikut që të detyrohet i padituri A. (M.) K. nga Komuna e Junikut në emër shpërblim dëmit material dhe jo material tija paguan shumë prej 11.000.00 euro, me kamat siç e paguajnë bankat afariste në Kosovë për mjetet e deponuar te qytetarëve pa afatizim dhe destinim të caktuar duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë më datën 07.04.2014 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit më dhune si e PA BAZUAR. Në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit ka vendosur që: Secila palë i bartë në vete shpenzimet e procedurës kontestimore

Kundër këtij aktgjykimi paditësi në afatin ligjor kanë paraqitur ankesë, duke mos i specifikuar shkaqet për të cilat e atakon vendimin, me propozim që Gjykata Apelit ta aprovoj ankesën dhe aktgjykimin e atakuar ta anuloj dhe lëndën ta kthej në rigjykim për rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar i padituri me propozim që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit së tij, me datë 07.04.2014, në gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur padi, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit për kompensimin e dëmit, me arsye si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, C.nr.50/2014, i datës 18.04.2016, me të cilin e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: Nga provat e administruara, si aktvendimi për pushimin e hetimeve, raportet mjekësore Nga raportet mjekësore që gjenden në shkresat e lëndës të sjella nga ana e paditësit të lëshuara nga Spitalit Regjional në Pejë më numër 3070 të datës 10.03.2013, Raportit mjekësor QKU Prishtinë Klinika ORL më numër 1417 të datës 03.04.2013, Raportit mjekësor QKU Prishtinë Klinika ORL të datës 10.01.2014, gjykata erdhi në përfundim dhe vërtetoi në mënyrë të pa dyshimtë se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar në kuptim të nenit 158 par 1,2 të Ligjit Nr. 0410/-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimin. Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata nuk vendosi nga se paditësi nuk i ka paraqitur listën e shpenzime gjykatës sipas nenit 463 të LPK.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Gjykata e Apelit i vlerësoi pretendimet ankimore të parashtruara me ankesë, mirëpo gjeti se të njëjtat janë të pa bazuara. Nga shikimi i shkresave të lëndës nuk është vërtetuar me asnjë provë të vetme se i padituri i ka shkaktuar lëndime paditësit e si pasojë e kësaj paditësi ka humbur dëgjimin. Nga raportet mjekësore të paraqitura në gjykatë, të njëjtat nuk vërtetojnë se si pasojë e lëndimeve të shkaktuara nga i padituri, paditësi ka humbur dëgjimin, realisht nuk është provuar me asnjë provë se palët ndërgjyqëse kanë hyrë në konflikt fizik, se i padituri e ka goditur paditësin e kjo vërtetohet edhe nga aktvendimi për pushimin e hetimeve të , PP-II-387/2013, i datës 10.10.2013 ku prokurori i shtetit ka gjetur se nuk ekziston dyshimi i bazuar se është kryer vepra penale e lëndimi të lehtë trupor.

Për të lindur e drejta që paditësit ti takojë kompensimi i dëmit, duhet që fillimisht dëmi të jetë shkaktuar, e meqenëse në rastin konkret me asnjë provë të vetme nuk është provuar se i padituri i ka shkaktuar dëm të çfarëdo lloji paditësit, Gjykata e Apelit e përkrah vendimin e gjykatës së shkallës

së parë si të drejtë dhe të ligjshëm kur ka konstatuar se duhet refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit në shumë prej 11.000.00 euro nga i padituri. Paditësi ka dështuar që në procedurë të vërtetohet lidhjen kauzale shkak-pasojë, pra baza e padisë mungon, sepse për të lindur e drejta për kompensim të dëmit të shkaktuar si rezultat i veprës penale, duhet të ketë aktgjykim të plotfuqishëm, përmes të cilit vërtetohet se paditësi si pasojë e konfliktit me të paditurin ka pësuar lëndime. Paditësi me asnjë provë relevante nuk i ka mbështetur pretendimet e tij, dhe të njëjtat pretendime kanë mbetur të pa provuara, pasi paditësi edhe sikur të argumentonte se ka pësuar dëme, e drejta për kompensim duhet ti ketë lindur nga shkaktari i dëmit e që në këtë rast është i padituri, andaj në rastin konkret paditësi në procedurën e kompensimit të udhëhequr pranë gjykatës së shkallës së parë nuk ka arritur të vërtetohet dëmin e pësuar, lidhjen kauzale dhe shkaktarin e dëmit.

Neni 183 i LMD-së përcakton se: *“Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personA.tetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”*, andaj meqenëse pretendimet e paditësit nuk gjejnë mbështetje në nenin e sipërcituar, Gjykata e Apelit vendosi që ta refuzoj ankesën e paditësit si të pa bazuar dhe ta vërtetohet aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.63/18, me datë 04.08.2021

Kryetari i kolegjit
Faton Ademi